




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9835/24 datë:19.04.2024



Npi – 01/147 datë: 29.04.2024

Bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) neni 17 shkronjat (b dhe f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 11, 13 dhe 14.3 shkronja (d) të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore. Kuvendi Komunës, pasi analizoi Rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa, dhe propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2024, miratoi këtë

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT Npi-01/251 TË DATËS 27.06.2023

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -IV- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 29.04.2024, me shumicën e votave miratoi SHFUQIZIMIN e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/251 të datës 27.06.2023, për destinimin në rrugë publike pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr.P-00325-0, me sipërfaqe prej 153 m², në Zonën Kadastrale - Karaqicë, Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes.

II

A r s y e t i m: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës e ka njoftuar Kuvendin e Komunës së Shtimes me shkresën Nr.02/3976-2/23 të datës 25.07.2023 me të cilën konfirmon se Vendimi i Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01-251 i datës 27.06.2023, Për destinimin në Rrugë Publike pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr.P-00325-0 me sipërfaqe prej 153 m², në Zonën Kadastrale - Karaqicë, Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes, nuk është në përputhje me Ligjin.

Kuvendi i Komunës e ka analizuar aktin e vlerësimit të ligjshmërisë që i është bërë nga MMPHI-ja, si dhe propozimin e DPUKGJ-së Nr.02/324 të datës 22.04.2024 për shfuqizimin e këtij vendimi, dhe pas shumë diskutimeve me shumicën e votave mori vendim sikurse në dispozitiv.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi